



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Ministrja e Ministrisë së Drejtësisë,

Në mbështetje të Nenit 189 (paragrafi 5) të Ligjit nr. 08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, në përputhje me nenin 11, paragrafi 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në Shtojcën 1 (pika 3) të Rregullores (QRK) - NR. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 38 paragrafit 6 të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare nr. 15, e datës 12.09.2011),

Nxjerrë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV MD -Nr. 08/2023¹
PËR MËNYRËN E KRYERJES SË INSPEKTIMIT TË BRENDSHËM NË
INSTITUCIONET KORREKTUESE DHE DREJTORITË RAJONALE
SPROVUESE

¹Udhëzim Administrativ Md-Nr. 08/2023 për mënyrën e kryerjes së inspektimit të brendshëm në institucionet korrektuese dhe drejtoritë rajonale sprovuese i nënshkruar nga Ministrja e Drejtësisë, më datë 06.09.2023.

Neni 1

Qëllimi

Me këtë Udhëzim Administrativ rregullohet mënyra e kryerjes së inspektimit të brendshëm në Institucionet korrektuese dhe Drejtoritë Rajonale Sprovuese (në tekstin e mëtejme: Inspektorati).

Neni 2

Fushëveprimi

Inspektimit të brendshëm sipas këtij Udhëzimi Administrativ i nënshtrohen të gjitha institucionet korrektuese dhe drejtoritë rajonale sprovuese.

Neni 3

Parimet e punës të Inspektoratit

1. Inspektorët në kryerjen e detyrës së tyre janë të pavarur dhe të paanshëm nga çdo ndërhyrje e cila mund të ndikoj në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë.
2. Inspektorët duhet të kryejnë detyrën e tyre me aftësi profesionale e me përgjegjësi të plotë dhe janë të lirë nga çfarëdo ndërhyrje që mund të ndikoj në gjykimin e drejtë të tyre, ose në rezultatin e kontrollit.
3. Në kryerjen e detyrave të inspektimit, inspektori është i pavarur dhe ndërmerr veprime në bazë të ligjit dhe të dispozitave tjera.
4. Inspektorati gjatë punës së vet duhet ta respektoj parimin e konfidencialitetit të informacioneve dhe të dhënave.
5. Inspektorati gjatë punës së vet duhet të trajtoj dokumentacionin konfidencial në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 4

Kryerja e Inspektimit

1. Inspektorati në pajtim me autorizimet ligjore, bënë mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.
2. Inspektoriati inicon procedurën e inspektimit sipas detyrës zyrtare, apo me iniciativën e personit të interesuar.
3. Inspektoriati ka këto autorizime:
 - 3.1. të hyj në çdo kohë dhe pa paralajmërim në të gjitha hapësirat dhe lokalet e institucionit korrektues dhe Sprovues me qëllim të inspektimit;

3.2. të urdhëroj që lëshimet dhe të metat e konstatuara të eliminohen në afatin të cilin inspektori e cakton;

3.3. të verifikoj secilin rast veç e veç, çdo herë kur dyshohet për shkelje ligjore. Inspektori inicion procedurën qoftë sipas detyrës zyrtare, apo me iniciativën e personit të interesuar;

3.4. t'u rekomandoj subjekteve përgjegjëse ndërmarrjen e masave disiplinore në pajtim me strukturën hierarkike.

4. Inspektoriati aktivitetin e vetë e ushtron në bazë të planit vjetor të punës, të cilin e harton në fillim të vitit kalendarik.

5. Inspektoriati gjatë hartimit të planit të punës bazohet në objektivat strategjike të Ministrisë së Drejtësisë me qëllim të plotësimit të standardeve në Shërbimin Korrektues të Kosovës (në tekstin e mëtejme :SHKK) dhe Shërbimin Sprovues të Kosovës (në tekstin e mëtejme: SHSK).

Neni 5

Koha e kryerjes së inspektimit

1. Inspektimi bëhet në bazë të planit vjetor të punës së Inspektoratit.

2. Përfundimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, Inspektorati kryen inspektimin si në vijim:

2.1. sipas urdhrit me shkrim të Ministrit të Drejtësisë;

2.2. me kërkesën e Drejtorit të Përgjithshëm të SHKK apo Drejtorit të Përgjithshëm të SHSK, dhe sipas kërkesës të dhënë gojarisht, në raste të jashtëzakonshme, i cili pasohet me kërkesë me shkrim, pa vonesë.

2.3. me kërkesën e Drejtorit të Institucionit Korrektues, apo Udhëheqësit të Drejtorisë Rajonale Sprovuese përmes Drejtorit të Përgjithshëm të SHKK, përkatësisht SHSK.

Neni 6

Mënyra e kryerjes së inspektimit

1. Inspektimi kryhet me inspektim të drejtpërdrejtë të kushteve dhe mënyrës së punës të të punësuarve, kushtet dhe mënyrën e punës dhe të strehimit për të burgosurit.

2. Inspektimi kryhet duke bërë vlerësimin e punës në institucionin korrektues dhe sprovues në pajtim me legjislacionin në fuqi.

3. Në zbatimin e mbikëqyrjes, inspektorët mund të bisedojnë me personat e dënuar pa prezencën e punëtorëve korrektues, si dhe me të gjithë të punësuarit në institucionin korrektues dhe sprovues pa prezencën e udhëheqësve të tyre të drejtpërdrejtë, apo të udhëheqësit të institucionit korrektues dhe sprovues.

4. Kur vlerëson se kjo është e nevojshme, inspektori mundet personave nga paragrafi 3 i këtij neni t'i u merr deklaratë në procesverbal.

5. Përmes inspektimit bëhet vlerësimi vjetor i secilit institucion korrektues dhe drejtorive rajonale sprovuese përmes:

5.1. përcaktimit nëse veprimet janë kryer në mënyrë efektive, në veçanti ato lidhur me procedurat e pranimit, zbatimin e dënimeve disiplinore, çështjet e sigurisë, sigurimit të shërbimeve shëndetësore, mjekësore dhe sigurimit të ndihmës edukative dhe shoqërore;

5.2. shqyrtimit të besueshmërisë së informacioneve financiare dhe atyre drejtuese;

5.3. vërtetimit, nëse pasuritë që i takojnë Shërbimit Korrektues të Kosovës kontrollohen dhe sigurohen nga humbjet, në veçanti mirëmbajtja dhe pastërtia e objekteve;

5.4. vlerësimit të shfrytëzimit efektiv të burimeve njerëzore;

5.5. mbikëqyrjes nëse janë arritur objektivat e përcaktuara të programeve

5.6. mbikëqyrjes së funksionimit të masave dhe sistemit të sigurisë në institucionet korrektuese;

6. Subjekti të cilit i është urdhëruar eliminimi i të metave dhe parregullsive është i detyruar që pas eliminimit të të metave dhe parregullsive të lajmëroj inspektoratin në afatin e caktuar nga inspektorati dhe i cili nuk mund të jetë më i gjatë se tetë (8) ditë.

Neni 7

Inspektimi i drejtorive rajonale sprovuese

1. Inspektoriati inspekton drejtoritë rajonale sprovuese, nëse:

1.1. anketat sociale dhe raportet përkatëse janë përgatitur në pajtim me ligjin dhe afatet e përcaktuara;

1.2. janë realizuar aktivitetet e programit lidhur me masat edukative, mbikëqyrjen e dënimeve alternative dhe lirimin me kusht në përputhje me ligjin dhe standardet e punës së SHSK-së;

1.3. ekzekutimi i masave të diverstietit dhe masave edukative për të mitur është realizuar brenda afatit;

1.4. evidencat dhe regjistrat për ekzekutimin e masave dhe dënimeve alternative mbahen në pajtim me ligjin dhe standardet.

Neni 8

Inspektimi i fushave të veçanta

Mbikëqyrjen e punës së institucioneve korrektuese dhe drejtorive rajonale të shërbimit sprovues lidhur me kontrollin e punës financiare, marrëdhënies së punës, mbrojtjes në punë, mbrojtjes

shëndetësore dhe sanitare të personave të dënuar dhe të paraburgosur, të kushteve dhe mënyrës së pranimi të ushqimit e kryejnë organet e autorizuar në pajtim me dispozitat e veçanta.

Neni 9

Inspektimi në bazë të kërkesës

1. Me kërkesën e stafit të institucionit korrektues, të burgosurit dhe personit të interesuar, inspektorati do të filloj inspektimin sipas rastit të kërkuar.
2. Nëse vërtetohet veprimi jo i ligjshëm ndaj stafit, të burgosurit, inspektori, përpos veprimit të tij zyrtar për çështjen konkrete, do ta udhëzojë edhe për të drejtat e tij.

Neni 10

Procesverbali i inspektimit

1. Inspektorati gjatë çdo inspektimi përpilon procesverbal të veçantë.
2. Inspektorati pas çdo inspektimi të kryer përpilon procesverbal në të cilin jep urdhër apo rekomandim për eliminimin e parregullsive dhe të metave të konstatuara gjatë inspektimit.
3. Procesverbali i përmban këto të dhëna:
 - 3.1. fushën dhe mënyrën e inspektimit;
 - 3.2. përmbajtjen kryesore të inspektimit;
 - 3.3. faktet e vërtetuara;
 - 3.4. kundërshtimet nga subjekti i inspektuar;
 - 3.5. urdhrat e dhëna për mënjanimin e parregullsive të konstatuara;
 - 3.6. rekomandimet dhe propozimin e masave;
 - 3.7. afatin e përmbushjes së urdhrave.
4. Procesverbalin e nënshkruhet nga anëtarët e ekipit të inspektoratit që kanë bërë inspektimin.
5. Inspektorati pas çdo inspektimi dhe konstatimi të shkeljeve i diskuton të njëjtat me zyrtarin përgjegjës të institucionit përkatës.
6. Procesverbalit i bashkëngjiten dokumentacioni i cili e përbën dosjen, e cila është lëndë e inspektimit.
7. Procesverbali lidhur me kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese i dërgohet Ministrit, Drejtorit të Përgjithshëm dhe Drejtorit të Institucionit Korrektues, përkatësisht Drejtorit të Përgjithshëm të

Shërbimit sprovues dhe Drejtorit të Drejtorisë Rajonale Sprovuese ku është kryer mbikëqyrja inspektuese.

Neni 11

Raport për inspektim

1. Pas raportimit të institucionit korrektues për eliminimin e të metave dhe parregullsive të konstatuara gjatë inspektimit, inspektorati e bën verifikimin e përmbushjes së urdhrave të konstatuara në procesverbal.
2. Pas verifikimit nga inspektorati për përmbushjen e urdhrave të konstatuara në procesverbal, inspektorati e njofton Ministrin e Drejtësisë me raport zyrtarë për përmbushjen e urdhrave nga institucioni korrektues.
3. Në rast se institucioni korrektues nuk ka përmbushur urdhrat e cekura në procesverbal për të gjeturat gjatë inspektimit, Inspektorati e njofton Ministrin për mos përmbushjen e urdhrave nga institucionit korrektues.

Neni 12

Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ shfuqizohet Udhëzimi Administrativ MD-Nr. 11/2013 për mënyrën e kryerjes së inspektimit të brendshëm në institucionet korrektuese.

Neni 13

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi 7 (shtatë) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albulena Haxhiu

Ministre e Drejtësisë

____.____.2023